



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME  
SEKTORI I GJENDJES CIVILE

DATA/DATUM/DATE	13.01.2025
NR/BR.	Zyrtarisht
PËR/ZA/TO	Agesa Hajredini Drejtores e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Drejtperdrejt
NGA/OD/FROM	z. Nesret Ademi Udhëheqësi i Sektorit të Gjendjes Civile
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Raporti i Sektorit të Gjendjes Civile nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024

Raport i punës  
Janar-Dhjetor 2024

Ky shërbim operon si zyre e gjendjes civile në komunën e Ferizajt, me vendim të këshillit komunal për organizimin e ri të shërbimit të gjendjes civile është vendosur që shërbimi i gjendjes civile të funksionojë si një zyre e gjendjes civile me seli në komunë dhe është duke funksionuar shumë mirë. Trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve me të mira dhe me efikasitet është në ngritje në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe po ashtu në këtë trend pozitiv ka ndikuar edhe kthimi i librave të gjendjes civile dhe atyre fetare, ngase, kanë ndikuar në lehtësimin dhe shpejtimin e procedurave për tu pajisur me certifikata dhe dokumente të gjendjes civile.

Siç dihet me aplikimin e programit të ri të gjendjes civile janë hequr librat fizik dhe me rastin e regjistrimit të një fakti në sistem gjegjësisht në program, atëherë shtypet një akt i cili pasqyron shënimet e gjendjes civile për atë regjistrim dhe në fund të vitit kalendarik këto akte lidhen dhe formohen librat e të lindurve, të martuarve dhe të vdekurve për zyrën e gjendjes civile për çdo vit kalendarik ku edhe për vitin që lamë pas 2024 kemi bërë libër lidhje dhe në fillim të vitit 2024 do të përgatitemi për libër lidhje të akteve për vitin 2025.

Me qëllim që të kemi shërbime më efikas dhe më efektive në si zyre e gjendjes civile kemi nevojë edhe për një mbështetje në aspektin nëpunësve profesional dhe me mjete të teknologjisë informative si me kompjuter, fotokopjues dhe skaner, ngase aktualisht posedojmë vetëm një fotokopjues që është gjysmë funksional dhe vetëm një skaner të kapacitetit të vogël dhe me të cilën shërbehemi të gjithë zyrtarët e gjendjes civile kompjuterët për zyrtarët e gjendjes civile duhet të jenë me të avancuarit sepse programi e Gjendje Civile është program që kompjuteri duhet të ketë kapacitet të madhe edhe me këta kompjuter që kemi për momentin vështirë po hapet programi për arsyeje sepse kompjuterit kanë kapacitet të vogël, printerët edhe pse janë të ndërruara nga OE që është fitues dhe

printerët kane kapacitet te ngadalshme ne shpëtuesin e printimit, gjate printimit edhe neve po nga shkaktojnë problem.

Gjate kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe ju është dhënë përgjigje të gjitha kërkesave te palëve për te cilat parashihet afati me i shkurtër 1-7 dite, ndërsa për kërkesat për te cilat parashihet afat me i gjate deri 45 ditë të përgjigje ne kërkesë pas shqyrtimit në komisionin përkatës dhe pas aprovimit dhe shqyrtimit nga Agjensioni i Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të brendshme janë përfunduar brenda afateve qe parashihen ne ligjet pozitive te Republikës së Kosovës. Komuna e Ferizajt ka bashkëpunimin me spitalin e qytetit për raportimin e te gjitha fakteve te lindjes qe ndodhin ne spitalin e qytetit pas një marrëveshje dhe një bashkëpunimi të ndërsjellët që kemi krijuar me këtë institucion dhe me qellim te regjistrimit te fëmijëve brenda afatit ligjor dhe te mos kaloj ky afat 30 ditor dhe te mos gjobiten qytetaret për kalimin e afatit 30 ditor për regjistrim e rregullt te fakteve te lindjes kemi dërguara një Zyrtar te Gjendjes Civile me qellim qe ti krijohet mundësia nenave te porsalindur qe te respektojë afate për regjistrim e fëmijëve .

Zyra e gjendjes civile i ka marr te gjitha masat qe te zbatoje vendimin e MAPL-se për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas te të gjitha fakteve te lindjes për komunitetin RAE, mirëpo ne zyrën e gjendjes civile ne komunën e Ferizajt nuk është paraqitur asnjë rast i këtij komuniteti për regjistrim me vonesë dhe falas.

Shërbimi i gjendjes civile është duke punuar sipas orarit te caktuar nga kryetari i komunës, që nënkupton prej orës 08:00 deri ne ora 16:00 ndërsa puna me pale nga ora 08:30 me qellim te shqyrtimit te lendeve dhe shkrimin ne klauzola mbushja e ASK-ve shqyrtimi i lëndëve nga Intraneti ... etj .

Kemi arritur qe ne zyrën e gjendjes civile te vendosim sistemin e radhëve duke krijuar kushte shume me te mira për qytetarët dhe zvogëlimin e parregullsive me rastin e pritjeve dhe marrjes së shërbimeve në zyrën e gjendjes civile duke krijuar edhe hapësirën për pritje të qytetarëve brenda kësaj zyre pasi qe fuzionomi te zyrave te gjendje civile dhe shtimit te numrit te zyrtar te gjendjes civile presim qe edhe këta zyrtar ti vendosin aparate numrat secilit zyrtar me qellim te ri funksionimit të sistemit te numrave e te shërbimeve me radhe .

Në vazhden e ofrimit të shërbimeve më efikase dhe më efektive ne kemi dy arka ku mendojmë qe ne vitin 2024 te thjeshtëzojmë procedurat e pagesave për marrjen e certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile, duke krijuar mundësinë që të gjitha pagesat për këto shërbime të kryhen në sportel te zyrtari i njëjtë i cili e jep shërbimin.

Zyra e Gjendjes Civile ka bërë përgatitjet edhe për pritjen e mërgimtareve gjatë muajve të verës dhe te muajit dhjetor - janar ku kërkesat për certifikata dhe për shërbime të tjera nga gjendja civile janë më të mëdha, andaj kemi pranuar edhe 2 (dy ) punëtor me kontratë për shërbime të veçanta me qëllim që të krijojmë kushtet për trajtim sa me të mirë dhe më të shpejtë për mërgimtarët e komunës së sonë.

Zyra e Gjendjes Civile ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë interes dhe nevojë për shërbime nga kjo zyrë dhe në vazhden e këtij bashkëpunimi kemi pasur shumë takime, konferenca dhe trajnime me organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Në vazhdimësi jemi duke bashkëpunuar ngushte me Gjykatat e Kosovës, Entin e sigurimeve pensional të Kosovës dhe të shteteve të huaja dhe në çdo kërkesë i përgjigjemi në kohe, brenda ditës ose sipas afateve që i cakton gjykata, ngase kërkesat e gjykatës janë gjithmonë me urgjencë dhe si të tilla edhe i trajtojmë ku edhe për vitin 2024 ju kemi përgjigjur te gjitha kërkesat e arritura ne Sektorin e Gjende Civile.

Nga vite 25.02.2022 ka hy ne fuqi Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 01/2022 për dokumente e gjendje Civile i cili udhëzoi ja ka mundësuar te gjithë qytetareve te Republikës se Kosovë qe disa shërbime te Gjendes Civile te bëhen nga Platforma Elektronike E-Kosova edhe ka pasur efektin e vete sepse për çdo muaj është duke u shtuara shërbimi ne E-Kosovë nga qytetaret.

Duke u bazuara ne Udhëzimin administrative (MPB) NR.01/2022 PËR DOKUMENTET E GJENDJES CIVILE Sektor i Gjendjes Civile ka treguara një avancim ne shërbimet me qytetar sepse disa dokumentet te Gjendje Civile qytetarë i kanë marr online ku këta dokumente te Gjendjes Civile kane rendësi dhe janë te barasvlershmi me dokumente te cilat nxjerrën ne Komune pra zyrtareve dhe ketë vit ka treguara një rritje te madhe ne këta shërbime.

DDukndara mënyra e zbatimit te saj për përdorim brenda vendit dokumentet e gjendjes civile lëshohen në letër të bardhë standarde të formatit A4, ndërsa dokumentet për përdorim jashtë vendit lëshohen në letër të veçantë sipas specifikave të përcaktuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil.

Komuna e Ferizajt Administrata e Përgjithshme ka bere një njoftim ne faqe te Komunës dhe ka dërguara emali për implementimin e udhëzimit dhe se obligohen qe te gjitha institucionet relevante qe te paranojnë dokumente për përdorim te më brendshëm dhe te shërbimet online ti pranojnë si dokumente te lëshuara nga Gjendje Civile.

Implementim i këtij udhëzimi dhe njoftimi qe ju be institucione relevante pati efekt dhe i kane pranuar dokumente sipas udhëzimit me te hyr ne fuqi te udhëzimit administrativ, pasi qe te gjitha masati preventive janë marre nga Drejtori i Administrate së Përgjithshme për implementim e udhëzimit e qëllimi kryesor është shërbimet për qytetarët që te jetë sa me letë qe qytetarë ta marrin shërbimin pa prit ne radhë para sporteleve.

Nga Data 01.10.2024 ne Program te Gjendjes Civile është duke u implentuara edhe Programi NDERLIDHEJ E QYATARVE ME ADERSAT është vetëm 2 muaj ne vitin qe po e lemë pas mirëpo është një interesim i mire i qytetareve për ndërlidhe te adresave sepse tek qytetaret ne praktik ka pasur adresa te ndryshëm ku me një adresa nga Gjendja Civile ka qen ndryshe ne PTK ndryshe ne Pastërtitë ndryshe ne Bifurkacion ndryshe e për këtë arsyeje ka qen e nevojshme ky program ku qytetarët te kenë një kërkesë ne E-Kosova apo tek zyrtaret nga AKK mund te harmonizojnë me një adresë te sekt për vete dhe për anëtarët e tjerë te familje me një adresë te vetme.

Qëllimi - Përmes këtij procesi mundësohet ndërlidhja e qytetareve me adresat, e cila do te jete zyrtare dhe unike

Fushëveprimi - ne këtë proces përfshihen Zyra e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Urbanizmit te Komunës se Ferizajt niveli lokal si dhe Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Agjencia e Kadastrat ne nivelin qendror.

Mënyra e realizimit te procesit me adresat zyrtare dhe unike është duke u realizohet ne dy mënyra

Duke deklaruar adresën Zyrtare ne E-Kosova dhe duke Deklaruar adresën zyrtare ne zyrën e Gjendjen Civile pran zyrtareve.

Përfitimet e qytetareve me përdorimin e adresave zyrtare

Adresa unike ne te gjitha shërbimet komunale (fatura, e ujit, rrymës, mbeturinave... etj.)

Planifikim i shërbimeve shëndetësore adekuate sa me afër qytetarëve;

Planifikimi i duhur i çerdheve dhe shërbimeve te tjera komunale;

Pranimi i dokumenteve te ndryshme si letërnjoftimi, pasaporta , ne adresën tuja te saktë.

Më së miri punën e zyrës së gjendjes civile për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023 e pasqyron tabela e poshtëshënuar, e cila tregon në tërësi punën që është bërë nga zyra e gjendjes civile në shërbim të qytetareve duke i proceduar dhe realizuar kërkesat e palëve dhe duke bërë lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve të tjera të gjendjes civile nga zyra e Gjendjes Civile për komunën e Ferizajt.

### Numri i dokumenteve të lëshuara

Nr.	Përshkrimi	Përdorim te Brendshëm	Përdorim te Jashtëm
1.	Ekstrakt nga RQGJC	38530	10031
2.	Certifikata të lindjes	3773	19246
3.	Certifikata të martesës	3578	6028
4.	Certifikata të vdekjes	3364	903
5.	Certifikata të Statusit martesor	2226	899
6.	Certifikata të shtetësisë	452	554
7.	Certifikata familjare	7795	2236
8.	Certifikata të vendbanimit	5628	2795
9.	Vërtetim nga arkivi	589	773
		<b>65935</b>	<b>43465</b>
Gjithsej dokumente te lëshuara		<b>109400</b>	

### Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes Civile

<b>1</b>	<b>LINDJE</b>	<b>2425</b>
	1.1.Brenda Vendit	1538
	1.2.Jasht Vendit	381
	1.3. Me vonës	506
<b>2</b>	<b>MARTESA</b>	<b>1286</b>
	2.1.E Rregullt	1052
	2.2.Jashte Vendit	234
<b>3</b>	<b>VDEKJE</b>	<b>727</b>
	3.1.Brenda vendit	515
	3.2.Jasht vendit	57
	3.3. Me Vonesë	155
Gjithsej regjistrime të bëra		<b>4438</b>

**Numri i dokumenteve të lëshuara nga Platforma Elektronike E-Kosova**

1	Certifikata te lindjes	21221
2	Ekstrakt nga RQGJ	20690
3	Certifikata te martese	5645
4	Certifikata te vdekjes	669
Gjithsej		84225

**Raporti i adresa te regjistruara**

1	Adresat e regjistruara te deklaruar nga AKK	442
2	Deklarimi i adresave nga E - Kosova	247
Gjithsej		689

**Numri i kërkesave për fitim dhe lirim te shtetësisë**

1	Fitim të shtetësisë	251
2	Lirim të shtetësisë	20
Gjithsej kërkesa		271



**Shkresa te ndryshëm**

1	Njoftime për QPD për Ndërrim te emrit personal	74
2	Spektori i Verifikimit – ARC-lëndë për verifikim	34
3	Përgjigjeje kërkesave nga Gjykata dhe Prokuroria	196
4	Departamenti i Pensioneve te jashtme	12
5	Ekzekutimi te vendimeve për fitim te shtetësisë-	23
6	Ekzekutime te vendimeve për lirim te shtetësisë-	30
7	Ekzekutime te vendimeve për Rifitim te shtetësisë	10
8	Refuzime te vendime për humbe a fitim te shtetësisë	13
9	Policia hetuese	11
10	Përgjigjeje te ndryshëm	28
Gjithsej shërbime		<b>431</b>

Ferizaj 13.01.2025